

**BASHKIA TIRANË**  
FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR

Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Salillari” shpk &”Arb&Trans 2010” shpk  
Tirane Vore VORE Lagjja" Vore", Rruga e Vjetër , Vore- Marikaj, Km 1, Godina katër  
katëshe, Kati i tretë, Nr.5.

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “VAS Konstruksion” shpk &”4AM” shpk Rruga "Gjin  
Bue Shpata", hyrja 1, kati 5, Tiranë.

Lloji i procedurës së prokurimit: “Tender i Kufizuar” me Marrëveshje Kuadër në kuadër të procesit të rindërtimit.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-81300-12-07-2020

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore”.

Fondi / vlera e përafërt e kontratës /marrëveshjes kuadër: 70,514,075 (shtatëdhjetë milion e pesëqind e katërbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës/kontratave në kuadër të kësaj marrëveshje kuadër, për secilin pallat/godinë do të jetë 1 (një) javë kalendarike.

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Posaçëm i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 116 datë 09.12.2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: X oferta ekonomikisht më e favorshme □ çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë:

1. Operatori ekonomik “Stërkaj” shpk;
2. Operatori ekonomik “Inerti” shpk;
3. Operatori ekonomik “Biba X” shpk;
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Salillari” shpk &”Arb&Trans 2010” shpk;
5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “VAS Konstruksion” shpk &”4AM” shpk.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik “Sterkaj” shpk NUIS J68310708M

Operatori ekonomik “Stërkaj” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të kërkuar sipas Dokumenteve Standarte të Tenderit cka e bën të pavlefshme këtë ofertë

2. Operatori ekonomik “Inerti” shpk NUIS J66926804L

- Operatori ekonomik “Inerti” shpk nuk ka paraqitur sigurim oferte cka bie në kundërshtim me kërkesat e vecanta të Dokumenteve Standarte të Tenderit, gërma “c”: “*Sigurim oferte sipas Shtojcës 5, (ne Fazën e pare)*”.
- Operatori ekonomik “Inerti” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) punonjës Manovrator, për të cilët duhet të paraqitet: kontrata e punës e vlefshme, Dëshmi e Aftësisë Profesionale (e vlefshme) lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit*” pasi nuk është paraqitur dokumentacion për manovratorët e kërkuar.
- Operatori ekonomik “Inerti” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës/autobot Uji/6 copë*” pasi nga 6 autobotë uji të kërkuar janë dekaruar në Shtojcën e makinerive vetëm 2 copë.
- Operatori ekonomik “Inerti” shpk nuk plotëson pikën 6 të kapacitetit teknik të Dokumenteve Standarte të Tenderit: “*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës/fadroma me goma/6 copë*” pasi nga 7 fadroma me goma të deklaruara 2 prej tyre rezultojnë të parregullta, konkretisht një prej tyre është deklaruar dhe paraqitur vetëm me fatura dhe mjete me targë AEMT71 nga verifikimi I dokumentacionit rezulton eskavator me goma dhe jo fadromë me goma.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Inerti” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

**3. Operatori ekonomik “Biba X” shpk NUIS K32618815N**

- Operatori ekonomik “Biba-X” shpk ka paraqitur si punë të ngjashme Kontratën e sipërmarrjes me objekt: “Rikonstruksion i trotuarëve, Shëtitorja Nr. 2, Kavajë”. Referuar Situacionit përfundimtar të punimeve, rezulton se kontrata e paraqitur nuk konsiderohet punë e ngjashme me objektin e prokurimit: “*Demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore*”. Për sa më lart, Operatori ekonomik nuk plotëson DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 1.
- Referuar Shtojcës 13, Operatori ekonomik ka deklaruar se disponon 6 (gjashtë) fadroma me gomë, për të cilat ka paraqitur vetëm Faturat Tatimore dhe nuk janë të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar sipas DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8, gërma “a” dhe gërma “b”.
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik, referuar Shtojcës 13 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm për lidhjen e marrëveshjes kuadër:

- 1) Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Salillari” shpk & “Arb&Trans 2010” shpk, NUIS J62903125G & NUIS L02325001T.
- 2) Bashkimi i operatorëve ekonomikë “VAS Konstruksion” shpk & “4AM” shpk, NUIS L61322023P & NUIS K92005016L.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.12.2020

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Aktit Normativ Nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrores”, Neni 42, pika 10, nuk është paraqitur asnjë ankesë.